



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivety	12.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS+KCC	4214/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.593/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 593/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.593/2023 e datës 31.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET Vërejtja me shkrim e datës 20.03.2023 me nr.0327/23 e shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtëpërdrejt.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës , që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Zyrtar korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prizren sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 04.07.2018, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 31.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore Vërejtje me numër Nr.0327/23 të datës 20.03.2023 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren /Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoli 3367/2023 tek organi i punësimit. Këshilli me datë 25.04.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me numër protokoli 3795/2023 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3170/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi për shqiptimin e masës disiplinore datës 20.03.2023 me nr.0327/23 i Shërbimit Korrektues të Kosovës; rasti i refuzimit të urdhrit nga H.F ndaj mbikëqyrësit B.M më datë 07.03.2023; Informatë e datës 10.03.2023 ; Informatë e datës 15.03.2023; Informatë e datës 07.03.2023; Deklaratë e datës 10.03.2023; Informatë e datës 07.03.2023; Kërkesa për përgjigje e datës 06.04.2023 me numër protokoli 3367/2023; Përgjigje në ankesë e datës 25.04.2023 nga organi i punësimit me numër protokoli 3795/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 04.07.2023 për H.F; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 20.03.2023 me nr.0318 dhe Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 16.07.2018 për Sh.P.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi së ankesa e ankuesit është e **bazuar, sepse:**

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në Qendrën e paraburgimit në Prizren, ndaj ankuesit Haxhi Fetaj i cili mbanë pozitën "Zyrtarë Korrektues "në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me datë 20.03.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje ", me dyshimin se i njëjti ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës me arsyetimin se zyrtari ka refuzuar të kryej urdhërat e mbikëqyrësit të datës 07.03.2023 për ta përcjellur të burgosurin me inicialet D.M në spital, duke i thënë se është i zënë duke e shpërndar dreken edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se rasti është i ndjeshëm dhe duhet vepruar me urgjencë, dhe për këtë shkak zyrtarit i shqiptohet vërejtja me pretendimin ankimor se i njëjti ka refuzuar urdhërin e mbikëqyrësit. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se nuk kemi asnjë provë as nga ankuesi as nga dëshmitarët e tjerë lidhur me informacionin se ka pas refuzim të urdhërit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se me datën 07.03.2023 në momentin kur mbikëqyrësi i tij e ka urdhëruar ankuesin që ta dërgonte në spital të burgosurin

D.M, ai nuk e ka kundërshtuar urdhërin e mbikëqyrësit, këtë e ka deklaruar edhe z.B.M si epror i drejtëpërdrejtë. _____ i cili në deklaratën e tij të datës 07.03.2023 me nr.089/23 ka cekur se *ka qenë i angazhuar në shpërndarjen e ushqimit të detyrën e krahut B, dhe nga ai kam kërkuar që të shkojë në përcjellje deri në spital* " ndërsa zyrtari _____ ka thënë "nuk ka problem unë shkojë por jamë në shpërndarje të ushqimit në krahun B ku jam edhe kujdestar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore "Vërejtje", nga udhëheqësi i drejtëpërdrejtë, përmban shkelje të dispozitave procedurale duke pretenduar se vendimi i datës 20.03.2023 me nr.0327/2023 është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet "Vërejtja" e datës 20.03.2023.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankuesit, konstaton se Udhëheqësi i drejtëpërdrejt në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar e mbi këtë bazë edhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në këtë rast, nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 dhe nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar". Andaj kolegji i këshillit konstaton se përmbajtja e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje është i paqartë, jo i argumentuar, kundërthënës dhe i pakuptueshëm dhe nëse i referohemi Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 48 paragrafi 2 ku parashihet "2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e asaj që u potencua më lartë konstaton se Vendimi i datës 20.03.2023 me nr.327/23 i shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtëpërdrejt në Qendrën e Paraburgimit në Prizren është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në arsyetimin e sipërm si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda ,A.nr.593/2023, datë 12.05.2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

